



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr.14/2008;
më 17.06.2008, në ora 11:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Et'hem Çeku, Fatmir Rexhepi, Safete Hadergjonaj, Haki Shatri dhe Berim Ramosaj;

Munguan: Slobodan Petroviq, Mufëra Şinik, Kaqusha Jashari, Sala Berisha – Shala dhe Zef Morina;

Përcjellës prezent: Lumnije Murati nga Presidenca, Haxhi Gashi nga USAID dhe Blerina Uka nga NDI;

Nga zyra mbështetëse: Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Rishqyrtimi i Raportit të datës 27.05.2008, për Projektligjin për Plotësim Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-5 për Mbeshtetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme;
4. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Haki Shatri – theksoj se Komisioni, më datën 27. 05. 2008, e ka përfunduar shqyrtimin e Projektligjit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-5 për Mbeshtetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe nuk ka asnjë arsye të Rishqyrtohet Raporti të datës 27.05.2008.

Propozimi i z. Shatri u përkrah edhe nga deputetet Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj dhe Et'hem Çeku. Kundër këtij propozimi ishte vetëm deputetja Safete Hadergjonaj e cila insistoj të mbetet pika e tretë e rendit të ditës dhe të shqyrtohet raporti i datës 27.05.2008, meqenëse raporti ka gabime teknike dhe përmbajtësore. Ajo tha se duhet të ndryshohet amendamenti 1, pasi kushtetuta ka hyrë në fuqi ky amendament nuk ka kuptim. Po ashtu duhet ndryshuar edhe amendamenti nr.3, i cili i referohet nenit 4 të ligjit e sidomos paragrafi 1.1.3 pasi është vendosur që kriter për klasifikimin e ndërmarrjeve të jetë numri i punëtorëve dhe jo qarkullimi.Si dhe të futet amendamenti numër 6 ku parashihet mënyra e financimit të NVM, amendament i cili është miratuar në Komision.

Komisioni, pas diskutimeve, hoqi nga rendi i ditës pikën e tretë: Rishqyrtimi i Raportit të datës 27.05.2008, për Projektligjin për Plotësim Ndryshimin e Ligjit Nr.02/L-5 për Mbeshtetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, më arsyetimin se kjo çështje ka përfunduar më datë 27.05.2008.

Komisioni konstatoi se Raport i datës 27.05.2008, është valid dhe përfundimtar.

II. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

III. Të ndryshme;

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit për Raportet e Vizitave Zyrtare të Komisionit në Korporaten Elektroenergjitike të Kosovës (KEK) dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) dhe kërkoi prej tyre se a kanë vërejtje dhe sugjerime.

Bazuar në përmbajtjen e diskutimeve, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Miratohen Raportet e Vizitave Zyrtare të Komisionit në Korporaten Elektroenergjitike të Kosovës (KEK) datë 15.05.2008, dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) datë 04.06.2008;

Mbledhja përfundoi në orën 11:20;

Kryetare e Komisionit:

Myzejene Selmani